- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;
- c. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;
- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitet 2017, 2018, 2019 (në rastin e bashkimit të Operatoreve Ekonomik duhet të paraqitet vërtetim për çdo OE).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve 2017, 2018, 2019 të paraqitura pranë autoriteteve tatimore perkatese.

2.2.2. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron mesatare vjetore të tre viteve të fundit 2017, 2018, 2019 e cila duhet të jete jo me e vogel se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqese deshmi për furnizimet e meparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e zhvillimit të procedurave, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Operatori ekonomik për të vërtetuar përvojën e meparshme të realizuar me institucione shtetërore duhet të paraqese kontrata të ngjashme për furnizime të shoqeruara me vërtetim realizimi nga institucioni perkates (enti publik) për kontratën e realizuar.

- Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me subjekte private duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat, dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2.3.2. OE, për çdo lodër duhet të paraqesë “Deklaratë CE të Konformitetit” të prodhuesit, në përputhje me standardet e KE.

Deklarata e konformitetit identifikon lodrën për të cilën kjo deklaratë është hartuar.

Në deklaratën e konformitetit të paraqitur duhet të duket qartazi lidhja e produktit të paraqitur, me deklaratën e paraqitur.

2.3.3. OE duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që tregon lidhjen dhe bashkëpunimin e OE me prodhuesin e lodrave.

Për këtë duhet të paraqesë:

- Autorizim prodhuesi dhe/ose autorizim të distributorit të autorizuar dhe/ose kontratë bashkëpunimi me distributorin e autorizuar dhe/ose prodhuesin.

Në rastin kur OE ka kontratë bashkëpunimi/autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit që disponon distributor.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të disponojë 1 automjet që do të shërbejë për transportin e produkteve objekt prokurimi me masë maksimale të autorizuar 1 - 1.5 ton, në pronësi të tij ose të marrë me qera për transportin e mallrave objekt prokurimi.

- Në rastin kur mjeti është në pronësi të operatorit ekonomik, ai duhet të paraqesë: çertifikatën e pronësisë së mjetit, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit.
- Në rastin kur mjeti është marrë me qera, operatori ekonomik duhet të paraqesë: çertifikatën e pronësisë së mjetit, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik, siguracion të mjetit dhe kontratën e qerave me afat deri në fund të vitit 2020.

2.3.5. **Ditën e hapjes së tenderit**, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një mostër të realizuar sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor, të shoqëruar me “deklaratë CE të konformitetit” të prodhuesit në përputhje me standardet e KE për secilin nga artikujt e kërkuar. Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë D.P.Ç.K., Rruga e Barrikadave, Çerdhje nr. 1, Tirane.

Në secilën lodër duhet të jetë qartazi i dukshëm markimi “CE”.

Markimi CE vendoset në lodër në një etiketë të fiksuar në lodër ose në paketimin e saj në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqeshme.

Cdo artikull duhet të jetë i ambalazhuar në ambalazh të personalizuar, në të cilën duhet të duken qartazi emri dhe adresa e prodhuesit.

Në ambalazhin e secilës lodër duhet të jetë etikimi në gjuhën shqipe për:

- Emërtimin e lodrës
- Përshkrim i shkurtër i mënyrës së përdorimit.
- Materiali përbërës i lodrës.

- Moshë e këshilluar për përdorim.
- Vendi i origjinës

Etiketat e vendosura dhe instruksionet e përdorimit që shoqërojnë lodrat duhet të tërheqin vëmendjen e përdorueseve ose mbikëqyrësve të tyre mbi rreziqet dhe risqet e mundshme të dëmtimit që përfshihen gjatë përdorimit të lodrave si dhe mënyrat mbi shmangiet e rreziqeve dhe risqeve të tilla.

Mostrat duhet të paraqiten për artikujt e mëposhtëm:

Nr.	Emërtimi i Artikullit	Kerkesat e Procedures
1	Lodër me tërheqje me formë kafshe	<ul style="list-style-type: none"> - 1 (një) copë - Etiketimi: <ul style="list-style-type: none"> • Mostër "Emri i artikullit" • Data e zhvillimit të tenderit. • Emri e ofertuesit, • Nënshkrimi dhe vula e Operatorit Ekonomik.
2	Lodër me shtytje në formë kafshe	
3	Loder multifunksionale me kube didaktike dhe numrator	
4	Lodër didaktike për "qytetin"	
5	Koni me rathë me ngjyra	
6	Minipazëll 3D -Makinë policie	
7	Minipazëll 3D -Makinë ambulancë	
8	Minipazëll 3D -Makinë zjarrfikse	
9	Kub me faqe të ndryshme didaktike	
10	Kub me faqet me forma të prera didaktike	
11	Minipazëll -Radhitëse figura kafshësh	
12	Pazëll kafshësh shtëpiake	
13	Pazëll kafshësh të egra	
14	Radhitëse për kafshët e fermës me 8-10 elementë	
15	Radhitëse për imitim e peshkimit me pazëlla me magnet.	
16	Radhitëse për mjetet e transportit	
17	Labirint për kafshët e xhunglës	
18	Labirint për kafshët e fermës	
19	Radhitëse për numrat me bashkësi	
20	Ora	
21	Radhitëse për veprimet matematike	
22	Numrator i madh	
23	Radhitëse e shkronjave të alfabetit	
24	Set për mjetet e mjekut	
25	Kube ndërtuese me mjetet e transportit	
26	Mjetet e transportit hekurudhor	
27	Set mjetesh të sinjalistikës rrugore (jo më pak se 15 elementë)	
28	Daulle e madhe	
29	Topuz muzikor	
30	Daire	

31	Aeroplan me kurdisje	
32	Litar	
33	Metër vertikal për matjen e rritjes së fëmijëve	
34	Kamion me vegla pune	
35	Kamion didaktik	
36	Tabele didaktike me dy anë për të shkruajtur	
37	Karrige lëkundese	
38	Rrathë me ngjyra të ndryshme	

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila të përmbajë të dhënat: Mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.

Etiketa e ngjitur nuk duhet të mbulojë të dhënat e kërkuara më sipër.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dorëzimit të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shënim: Mos paraqitja e mostrave të kërkuara në vendin, ditën dhe orën e hapjes së ofertave për të gjithë mallrat objekt prokurimi është kusht për skualifikim.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar nëse është në gjuhën shqipe duhet të paraqitet në origjinal ose kopje e noterizuar e njëzuar me origjinalin. Nëse dokumenti është në gjuhë të huaj, duhet të paraqitet i përkthyer nga një përkthyes i licencuar, shoqëruar me vërtetim përkthimi nga Noteri, si dhe i noterizuar e njëzuar kopja me origjinalin nga Noteri.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar, ose paraqitja e dokumentave të rreme, përbën kusht për skualifikim.

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

ARGUMENTIM PËR HARTIMIN E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

Kriteret teknike të kualifikimit janë hartuar në përputhje të plotë me kërkesat specifike të përcaktuara me ligj:

- *Ligjin Nr. 10489 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", date 15/12/2011;
Ky Ligj është mbështetur plotësisht me vendimin nr. 768/2008/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008 "Mbi kuadrin e përbashkët për tregtimin e produkteve.*
- *Ligjin Nr. 10480, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore", datë 17/11/2011;*
- *VKM nr. 262, datë 03.04.2013 "Për miratimin e rregullit teknik për Sigurinë e Lodrave".
Ky VKM është mbështetur në Direktivën 2009/48/EC të Parlamentit Evropian, të datës 1 mars 2012 "Për sigurinë e lodrave" EUR-Lex, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 170 e datës 30.6.2009.*

Argumentim mbi përlogaritjen e fondit limit:

Fondi limit është përlogaritur duke ju referuar çmimeve të tregut sipas procesverbalit Nr.954/5 prot, datë 26.08.2020 "Për testimin e tregut për procedurën e prokurimit, me objekt "Blerje mjete didaktike", mbajtur nga Komisioni "Për hartimin e specifikimeve teknike, testimin e tregut dhe përcaktimin e kushteve të veçanta të kontratës".

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet teknike te mjeteve didaktike:

Nr	Artikulli	Grupmosha	Përshkrim i shkurtër i artikullit	Përmasat
1	Lodër me tërheqje me formë kafshe	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese prej druri me ngjyra të ndryshme (kafshë, qeni, lepuri, etj.), e paisur me litar për tërheqje. E pajisur me rrota prej druri për lëvizje	Përmasat e përafërta 13x10x6 cm. Ndryshimi i mundshëm ±3%
2	Lodër me shtytje në formë kafshe	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese prej druri me ngjyra të ndryshme (kafshë, ariu, lopa, bleta, etj.), e paisur me shkop druri për shtytje. E pajisur me rrota prej druri për lëvizje	Përmasat e përafërta 55x8,5x18 cm. Ndryshimi i mundshëm ±3%
3	Loder multifunkionale me kube didaktike dhe numrator	3-6 vjec	Lodër didaktike argetuese multifunkionale , e krijuar me material druri me forma gjeometrike dhe ngjyra te ndryshme, te cila stimulojne proceset njohese te femijes. Në hapësirat e prerjeve të faqeve anësore mund të futen format e ndryshme gjoemetrike	Përmasat e përafërta 19.3x19x18cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
4	Lodër didaktike për "qytetin"	3-6 vjec	Lodër didaktike argëtuese me bazament druri i cili përfaqëson qytetin dhe i paisur me mjete konvencinale të institucioneve të qytetit, pajisur me institucionet kryesore të qytetit, si dhe mjete te transportit, policise, ambulances, zjarrfikeses etj. Lodra është e pajisur me fije metalike në formë labirinti ku mjetet e ndryshme mund të lëvizin lirshëm.	Përmasat e përafërta 30x28x28cm Ndryshimi i mundshëm ±3%

Dokumentat Standarde të Tenderit

5	Koni me rrahë me ngjyra	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese me bazament prej druri, ku mbi të mund të rreshtohen rrahë prej druri, te cilet zvogelohen ne perpjestim te drejte nga baza ne maje duke krijuar formën konike.	Përmasat e përafërta 11x19,5x11cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
6	Minipazëll 3D - Makinë policie	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese, minipuzzle 3D, automjet me shënjat konvecinale të policisë, me material druri me elemente të çmontueshme dhe e paisur me rrota për lëvizje. Kjo lodër kërkon kombinimin e pjesëve të ndryshme për të krijuar formën e duhur të makinës së policisë	Përmasat e përafërta 9,5x5,5x9 cm. Ndryshimi i mundshëm ±3%
7	Minipazëll 3D - Makinë ambulancë	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese, minipuzzle 3D, automjet me shënjat konvecinale të ambulancës (ndihma e shpejtë), me material druri dhe me elemente të çmontueshëm e paisur me rrota për lëvizje. Kjo lodër kërkon kombinimin e pjesëve të ndryshme për të krijuar formën e duhur të ambulancës	Përmasat e përafërta 9,5x5,5x9 cm. Ndryshimi i mundshëm ±3%
8	Minipazëll 3D - Makinë zjarrfikse	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese, minipuzzle 3D, automjet me shënjat konvecinale të zjarrfikses, me material druri dhe me elemente të çmontueshëm e paisur me rrota për lëvizje. Kjo lodër kërkon kombinimin e pjesëve të ndryshme për të krijuar formën e duhur të zjarrfikësës	Përmasat e përafërta 9,5x5,5x9 cm. Ndryshimi i mundshëm ±3%
9	Kub me faqe të ndryshme didaktike	3-6 vjec	Lodër didaktike argëtuese, kub i realizuar me material prej druri ku në të 5-ta faqet e tij janë montuar versione të ndryshme lojrash formuese, argetuese dhe edukative. Format e montuara në faqet anësore të jenë të levizshme nga fëmijët. Secila faqe e këtij kubi ofron aktivitete të ndryshme.	Përmasat e përafërta 20x20x19 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
10	Kub me faqet me forma të prera didaktike	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese, kub me material druri ku në faqet anësore të tij janë kryer prerje të formave dhe madhësive të ndryshme. Brenda saj gjenden jo më pak se 10 elementë me prerje dhe forma të ndryshme të cilët iu përshtaten prerjeve të faqeve anësore të kubit. Fëmijët duhet të gjejnë hapësirën që i përshtatet formës gjeometrike të përzgjedhur prej tyre dhe ta hedhin në kub.	Përmasat e përafërta 15,5x15,5x15,5 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%

Dokumentat Standarde të Tenderit

11	Minipazëll - Radhitëse figura kafshësh	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese, minipazëll me material druri me radhitje me 9 figura kafshësh të ndryshme. Secila prej figurave është e ndarë në dy pjesë. Fëmijët nëpërmjet aftësive njohëse, duhet të përzgjedhin midis pjesëve të ndryshme për të ndërtuar saktë figurat e 9 kafshëve.	Përmasat e përafërta 22,5x22,5x0,8 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
12	Pazëll kafshësh shtëpiake	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese minipazëll me material druri me 4 elementë me figura të kafshëve shtëpiake. Brenda kutisë së drurit janë të vendosuar 3 elementë që përbëjnë figura kafshësh shtëpiake që vendosen njëra mbi tjetrën, të ndara me nga 4 elementë secila për formimin e figurës së 3 kafshëve shtëpiake.	Përmasat e përafërta 11,3x11,3x4,5 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
13	Pazëll kafshësh të egra	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese minipazëll me material druri me 4 elementë me figura të kafshëve të egra. Brenda kutisë së drurit janë të vendosura 3 elementë që përbëjnë figura kafshësh të egra që vendosen njëra mbi tjetrën, të ndara me nga 4 elemente secila për formimin e figurës së 3 kafshëve të egra.	Përmasat e përafërta 11,3x11,3x4,5 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
14	Radhitëse për kafshët e fermës me 8-10 elementë	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese pazëll me material druri në të cilën janë radhitur në mënyrë që mund të hiqen dhe vendosen lehtësisht figurat e 8-10 kafshëve të ndryshme të fermës. Secila prej figurave përkon me formën e saj në njërin prej formave që gjenden në bazamentin e radhitëses.	Përmasat e përafërta 30x22,5x2,2 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
15	Radhitëse për imitimin e peshkimit me pazëlla me magnet.	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese radhitëse në formë pazëlli me 8-10 forma druri të paisura me magnet për lloje të ndryshme të kafshëve të detit, të çmontueshme të paisura me magnet që formojnë temën mësimore të peshkimit, e shoqëruar me karrem me magnet.	Përmasat e përafërta 30x23,5x0,8 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
16	Radhitëse për mjetet e transportit	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese pazëll me material druri në të cilën janë radhitur në mënyrë që mund të hiqen dhe vendosen lehtësisht figurat e 15-20 mjeteve të mundshme të transportit tokësor, detar apo ajror.	Përmasat e përafërta 45x35x1,5 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%

Dokumentat Standarde të Tenderit

17	Labirint për kafshët e xhunglës	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese, radhitëse ku bazamenti ka një labirinth dhe forma të 8-10 kafshëve të ndryshme të pyllit. Bazamenti dhe format e kafshëve duhet të jenë me material druri. Pjesë të trupit të kafshëve mund të lëvizin lirshëm gjatë labirinitit për të krijuar figurën e saktë të kafshës së xhunglës.	Përmasat e përafërta 30x22,5x2 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
18	Labirint për kafshët e fermës	0-3 vjec	Lodër didaktike argëtuese, radhitëse ku bazamenti ka një labirinth dhe forma të 8-10 kafshëve të ndryshme shtëpiake. Bazamenti dhe format e kafshëve duhet të jenë me material druri. Pjesë të trupit të kafshëve mund të lëvizin lirshëm gjatë labirinitit për të krijuar figurën e saktë të kafshës shtëpiake.	Përmasat e përafërta 30x22,5x2 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
19	Radhitëse për numrat me bashkësi	3-6 vjec	Lodër didaktike argëtuese radhitëse për numrat me bashkësi përbëhet nga nëntë pjesë (për numrat 1-9) me material druri, që mund të hiqen dhe vendosen me lehtësi. Secila pjesë është një minipazëll që ka dy nënpjesë: njëra ka një numër (1-9), ndërsa tjetra një bashkësi figurash të caktuara numri i të cilave përkon me numrin përkatës.	Përmasat e përafërta 30x22,5x1 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
20	Ora	3-6 vjec	Lodër didaktike argëtuese Improvizim i orës së murit, me material druri, me forma numrash të cilët mund të hiqen dhe të vendosen me lehtësi, si dhe me akrepat e orës të lëvizshëm.	Përmasat e përafërta Ø 30x0,8 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
21	Radhitëse për veprimet matematike	3-6 vjec	Lodër didaktike argëtuese radhitëse për veprimet matematike, përbëhet nga nëntë pjesë (për numrat 1-9) me material druri. Secila pjesë është një minipazëll që ka 3 nënpjesë: njëra ka një numër (1-9), ndërsa dy të tjerat kanë një bashkësi figurash të caktuara shuma e të cilave është e barabartë me numrin përkatës.	Përmasat e përafërta 30x22,5x1 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
22	Numrator i madh	3-6 vjec	Lodër didaktike mësimore numrator me bazament druri me 10 rrjeshta me nga 10 golga lëvizëse me ngjyra të ndryshme.	Përmasat e përafërta 18,5x4,7x17,5 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%

Dokumentat Standarde të Tenderit

23	Radhitëse e shkronjave të alfabetit	3-6 vjec	Lodër didaktike mësimore radhitëse e shkronjave të alfabetit shqip përbëhet nga 36 pjesë (për shkronjat A-ZH) me material druri të cilat mund të hiqen dhe vendosen me lehtësi nga fëmijët.	Përmasat e përafërta 30x30x1,2 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
24	Set për mjetet e mjekut	3-6 vjec	Lodër didaktike argëtuese është një kuti në të cilën gjenden mjetet e mjekut. Mjetet të jenë material druri kryesisht dhe e ndërthurur me materiale ndihmës plastik apo metalik për aksesoret.	Përmasat e përafërta 19,5x7x14,5 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
25	Kube ndërtuese me mjetet e transportit	3-6 vjec	Lodër didaktike mësimore kuti brenda së cilës gjenden jo më pak se 50 elementë me ngjyra dhe forma gjeometrike të ndryshme me material druri të cilat shërbejnë për krijimin e modeleve të ndryshme (si p.sh. transportin rrugor)	Përmasat e përafërta 21x19x19cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
26	Mjetet e transportit hekurudhor	3-6 vjec	Lodër didaktike argëtuese që krijon imazhin e transportit hekurudhor. Pjesë të shkëputura që mund të montohen nga vetë fëmijët për krijimin e shinave të trenit, lokomotivës, vagonave. Krijuar me material druri e ndërthurur me material metalik dhe plastik. Kjo lodër didaktike konsiston në bashkimin e pjesëve të vogla të lodrës për krijimin e imazhit të transportit hekurudhor.	Përmasat e përafërta 35x23,5x6 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
27	Set mjetesh të sinjalistikës rrugore (jo më pak se 15 elementë)	3-6 vjec	Lodër didaktike argëtuese me shenjat konvencionale të qarkullimit rrugor. Të krijuara me material druri. Të realizuar në formë tabelash me bazamanet që mund të qëndrojnë mbi tavolonën e punës. Seti të përmbajë jo më pak se 15 shenja të ndryshme të qarkullimit rrugor.	Përmasat e përafërta 15x10x8cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
28	Daulle e madhe	2-6 vjec	Lodër didaktike argëtuese, instrument muzikor "daulle", e realizuar prej materiali druri, pëlhure dhe material ndihmës metalik. Seti përbëhet nga daullja, dy shkopinj druri dhe rripi, me anë të të cilin e mban të varur në qafë.	Përmasat e përafërta 24x16,5x24 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
29	Topuz muzikor	0-3vjec	Lodër didaktike argëtuese muzikore, topuz i dyanshëm, i krijuar me material prej druri dhe me ngjyra dhe dizeno të përshtatshme për fëmijë. Topuzi kur tundet krijon tinguj relaksues për fëmijët latantë dhe pas latantë.	Përmasat e përafërta 21,5x5,5x6,5 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%

Dokumentat Standarde të Tenderit

30	Daire	3-6 vjec	Lodër didaktike argëtuese, muzikore, daire, e krijuar me material druri për rrethin e daire dhe unaza metalike për muzikën.	Përmasat e përafërta 21x21x4 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
31	Aeroplan me kurdisje	3-6 vjec	Lodër didaktike, argëtuese, aeroplan me kurdisje, e krijuar kryesisht me material druri si dhe me aksesore ndihmës metalikë dhe plastikë	Përmasat e përafërta 9x10x5,5 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
32	Litar	3-6 vjec	Lodër didaktike mësimore dhe argëtuese, litar, e krijuar kryesisht me material të ndërthurur pambuku dhe gome. Gjatësia jo më pak se 5 m	Përmasat e përafërta 5m Ndryshimi i mundshëm ±3%
33	Metër vertikal për matjen e rritjes së fëmijëve	0-6 vjec	Mjet didaktik që shërben për matjen e rritjes (gjatësisë) së fëmijëve. I krijuar me material druri dhe i dizenuar me nëndrajt përkatëse të metrit si dhe me ngjyra ose figura të përshtatshme për fëmijë.	Përmasat e përafërta 100x10x1,3 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
34	Kamion me vegla pune	3-6 vjec	Lodër didaktike argëtuese, kamjon pune. I krijuar me material kryesisht druri dhe me aksesore ndihmës prej plastike dhe me ngjyra të përshtatshme për fëmijë. I çmontueshëm dhe I pajisur me vegla pune të cilat I shërbejnë punëtorit në aktivitetin e tij.	Përmasat e përafërta 32x24x15cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
35	Kamjon didaktik	3-6 vjec	Lodër didaktike mësimore dhe argëtuese, kamjon pune u mbushur me mjete didaktike, trupa të ndryshëm gjeometrikë. I krijuar me material kryesisht druri dhe me aksesore ndihmës prej plastike dhe me ngjyra të përshtatshme për fëmijë.	Përmasat e përafërta 32x16x21cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
36	Tabele didaktike me dy anë për të shkruajtur	3-6 vjec	Lodër didaktike tabelë e ndërtuar me kornizë druri dhe tabelë magnetike me dy faqe me aksesore ndihmës plastik dhe metalikë, ku mund të shkruhet me lapustin dhe me shkumës.	Përmasat e përafërta 40X10X60 Ndryshimi i mundshëm ±3%
37	Karrige lëkundese	3-6 vjec	Karrige lëkundëse në formë kali, lope, etj. E ndërtuar me material druri dhe me ngjyra të përshtatshme për fëmijë	Përmasat e përafërta 70x27x7cm Ndryshimi i mundshëm ±3%

38	Rrathë me ngjyra të ndryshme	3-6 vjec	Rreth plastik me diametër 50-70 cm, me ngjyra të ndryshme të përshtatshme për lojra argëtuese dhe zhvilluese për fëmijë.	Përmasat e përafërta Diametri: 50-70 cm Trashësia: 3 cm Ndryshimi i mundshëm ±3%
----	------------------------------	----------	--	--

Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:

Hartimi i specifikimeve teknike për mjetet didaktike është bërë duke iu referuar shkresës së Drejtorisë së Zhvillimit dhe Kujdesit në D.P.Ç.K, dhe Sektorit të Zhvillimit dhe Kujdesit Psiko-Social për llojet dhe format e mjeteve didaktike për kopshtet dhe çerdhet e Tiranës, grupmohave për të cilat do të përdoren këto mjete didaktike.

- Ligjin Nr. 10489 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", datë 15/12/2011;
 - Ligjin Nr. 10480, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore", datë 17/11/2011;
 - VKM nr. 262, datë 03.04.2013 "Për miratimin e rregullit teknik për Sigurinë e Lodrave".
- Për përcaktimin e specifikimeve janë patur parasysh plotësimin e Kërkesave Thelbësore të Sigurisë:

Kërkesat e përgjithshme të sigurisë:

Lodrat nuk duhet të rrezikojnë sigurinë ose shëndetin e përdoruesve ose palëve të treta kur ato përdoren si janë përcaktuar ose në mënyrën e parashikuar, duke pasur parasysh edhe sjelljen e fëmijëve (sidomos në rastin e grupmohës nën 6-muaj deri në 6 vjeç)

Kërkesat e veçanta të sigurisë:

1. Karakteristikat Fizike dhe Mekanike (të jenë të qëndrueshme, mos të kenë pjesë të vogla,)
2. Ndezshmëria (të mos ndizen nëse ekspozohen ndaj flakës, të japin një përhapje të ulet të flakës)
3. Vetitë Kimike nivelet e substancave mutagjene kancerogjene (CMR), e 19 metaleve të rënda si Cadmiumi, 55 substancat alergjente)
4. Karakteristikat Elektrike (Jo tension nominal >24 volt , temp të mos shkaktoj djegie, bateritë e fshehura të paksesueshme nga fëmijët)
5. Higjiena (të shmangët riskun ndaj infektimit, të mundësohet larja)
6. Radioaktiviteti (sipas legjislacionit për radioaktivitetin)

Lidhjet e lodrave duhet të kenë fortësinë e duhur mekanike, qëndrueshmërinë për të përballuar pa risk sforcimet;

Pjesët e mprehta, të ngriturat, kontakti me to të jenë të reduktuara sa më shumë.

Nuk duhet të paraqesin risk lidhur me mbytjen, gëlltitjen nga pjesët e vogla

Paketimi i lodrave (përmasat e përshtatshme të pacoptueshme për nën 36 muaj)

Lodrat, që japin lëvizshmëri , Sistemi i frenimit duhet të jete lehtësisht i përdorshëm

Temperatura maksimale dhe minimale në çdo sipërfaqe të mos shkaktojë dëmtime kur preket (lodrat me bateri, elektrike);

Kufiri i vlerave maksimale të impulsit të zhurmës dhe vazhdueshmërisë së zhurmës së tingullit (lodrat me tinguj, muzikore)

Të reduktojnë mundësisht sa më shumë riskun e shtypjes ose të kapjes të pjesëve të trupit, të rrobave dhe veshjeve, përplasjeve dhe mbytjes, (lodrat aktivizuese) etj.

Shtojca11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Artikulli	Njesia	Sasia
1	Lodër me tërheqje me formë kafshe	Copë	210
2	Lodër me shtytje në formë kafshe	Copë	210
3	Loder multifunksionale me kube didaktike dhe numrator	Copë	160
4	Lodër didaktike për "qytetin"	Copë	160
5	Koni me rrathë me ngjyra	Copë	75
6	Minipazëll 3D -Makinë policie	Copë	70
7	Minipazëll 3D -Makinë ambulancë	Copë	70
8	Minipazëll 3D -Makinë zjarrfikse	Copë	70
9	Kub me faqe të ndryshme didaktike	Copë	90
10	Kub me faqet me forma të prera didaktike	Copë	70
11	Minipazëll -Radhitëse figura kafshësh	Copë	105
12	Pazëll kafshësh shtëpiake	Copë	70
13	Pazëll kafshësh të egra	Copë	70
14	Radhitëse për kafshët e fermës me 8-10 elementë	Copë	70
15	Radhitëse për imitimimin e peshkimit me pazëlla me magnet.	Copë	70
16	Radhitëse për mjetet e transportit	Copë	160
17	Labirint për kafshët e xhunglës	Copë	70
18	Labirint për kafshët e fermës	Copë	70
19	Radhitëse për numrat me bashkësi	Copë	135
20	Ora	Copë	180
21	Radhitëse për veprimet matematike	Copë	180
22	Numrator i madh	Copë	225
23	Radhitëse e shkronjave të alfabetit	Copë	180

Dokumentat Standarde të Tenderit

24	Set për mjetet e mjekut	Copë	240
25	Kube ndërtuese me mjetet e transportit	Copë	160
26	Mjetet e transportit hekurudhor	Copë	240
27	Set mjetesh të sinjalistikës rrugore (jo më pak se 15 elementë)	Copë	160
28	Daulle e madhe	Copë	125
29	Topuz muzikor	Copë	140
30	Daire	Copë	160
31	Aeroplan me kurdisje	Copë	400
32	Litar	Copë	400
33	Metër vertikal për matjen e rritjes së fëmijëve	Copë	320
34	Kamion me vegla pune	Copë	135
35	Kamion didaktik	Copë	105
36	Tabele didaktike me dy anë për të shkruajtur	Copë	400
37	Karrige lëkundese	Copë	150
38	Rrathë me ngjyra të ndryshme	Copë	2050

Afatet e lëvrimit:

Lëvrimi i mallrave do të kryhet nga Operatori Ekonomik me kërkesën e Autoritetit Kontraktor duke filluar nga nënshkrimi i kontratës me perfundim në 31.12.2020.

Afati i lëvrimit të mallit është që nga data e lidhjes së kontratës, deri më 31/12/2020.

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur

Neni 1: Qellimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
